



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prijmjenol/Prodato Received/Delivery	16.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHACK	1266/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.600/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehemi dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.600/2022 të datës 03.04.2023, të parashtruar nga grupi i ankuesve

dhe kundër Përgjigjesë për rishqyrtimin e këreksës me Nr. Prot:126 të datës 28.03.2023 të Drejtorit të Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1088/2022 e datës 02.12.2022 e parashtruar nga ankuesit

II. Shfuqizohet akti me numer protokolli 126 e datës 28.03.2023 e Drejtorit të Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

III. Obligohet Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesit, të punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në pozitën "Zyrtar i Lartë Grumbullim dhe Përpunim të Informatave" në Qendrën e Situatave në Këshillin e Sigurisë

së Kosovës, më datë 10.11.2022 kanë parashtruar kërkesë tek Drejtori i Qendrës së Situatave në Prishtinë, për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për punën *e kujdestarisë, punën jashtë orarit , punën e natës, punën gjatë vikendit dhe punën gjatë festave zyrtare për muajin tetor 2022*. Ky i fundit përmes aktit me numër protokollit 418 të datës 24.11.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesve si të pa bazuar.

Ankuesit të pakënaqur me aktin me numër protokollit 418 të datës 24.11.2022, të Drejtorit të Qendrës së Situatave, me datë 01.12.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 7593/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë, për punën *e kujdestarisë, punën jashtë orarit , punë e natës, punën gjatë vikendit dhe punën gjatë festave zyrtare për muajin tetor, nëntor 2022*, deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.12.2022, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ndërsa me datën 16.12.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 16.01.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.1088/2022 përmes të cilit ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesve duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivesjoes për shqyrtimin e kërkesës së ankuesve tek Drejtori i Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës. Drejtori i Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës më datë 28.03.2023 përmes përgjigjes me Nr. Prot: 126 ka rishqyrtar kësaj kësaj e ankesës për kompensim të shtesës mbi pagën bazë.

Ankuesit kundër kësaj përgjigje më datë 02.04.2023 përmes ankesa.kpmshck@rks-gov.net, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 03.04.2023 me numër protokollit 3251/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, administroi keto prova: Ankesën me numër protokollit 3251/2022 e datës 03.04.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emailin e datës 02.04.2023 nga ankuesi T.M; Oratin e kujdestarisë janar , shkurt, mars, prill 2023; Formualrin per orë të kujdestarisë i datës 01.01.2023, 02.01.2023, 03..01.2023, 04.01.2023, 05.01.2023, 06.01.2023, 07.01.2023, 08.01.2023, 09.01.2023, 10.01.2023, 11.01.2023, 12.01.2023, 13.01.2023, 14.01.2023, 15.01.2023, 16.01.2023, 17.01.2023, 18.01.2023, 19.01.2023, 20.10.2023, 21.01.2023, 22.01.2023, 23.01.2023, 24.01.2023, 25.01.2023, 26.01.2023, 27.01.2023, 28.01.2023, 29.01.2023, 30.01.2023, 31.01.2023, 01.02.2023, 02.02.2023, 03.02.2023, 04.02.2023, 05.02.2023, 06.02.2023, 08.02.2023, 09.02.2023, 10.02.2023, 11.02.2023, 12.02.2023, 13.02.2023, 14.02.2023, 15.02.2023, 16.02.2023, 17.02.2023, 18.02.2023, 19.02.2023, 20.02.2023, 21.02.2023, 22.02.2023, 23.02.2023, 24.02.2023, 25.02.2023, 26.02.2023, 28.02.2023, 01.03.2023, 02.03.2023, 03.03.2023, 04.03.2023, 05.03.2023, 06.05.2023, 07.03.2023, 09.03.2023, 10.03.2023, 11.03.2023. 12.03.2023, 13.03.2023, 14.03.2023, 15.03.2023, 16.03.2023, 17.03.2023, 18.03.2023, 20.03.2023, 21.03.2023, 22.03.2023, 23.03.2023, 24.03.2023, 25.03.2023, 26.03.2023, 27.03.2023, 28.03.2023, 29.03.2023, 30.03.2023, 31.03.2023; Përgjigjen me Nr. Prot:126 të datës 28.03.2023 për rishytkmin e kërkesës për kompensim; Vendimin A.nr.1088/2023 të datë 16.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër A.nr.1088/2022 të datës 02.12.2022 me numër të protokollit 7593/2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil

të Kosovës, për mes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net, E-mail i datës 14.10.2022 nga ankuesi për znj.F.I; E-mail i datës 12.10.2022 nga për Kërkesë QS-KSK Nr.391 e datës 10.11.2022 nga ankuesit drejtuar Drejtorit të Qendrës së Sigurisë; Shkresë zyrtare e datës 24.11.2022 me nr. QS-SKSKNr.418 nga Drejtori i Qendrës së Sigurisë; Tabela nga pasqyra e orarit të kujdestarisë tetor 2022, e datës 04.10.2022 QS-KSK Nr.331; Tabela nga pasqyra e orarit të kujdestarisë tetor 2022, e datës 05.10.2022 QS-KSK Nr.333; Tabela nga pasqyra e orarit të kujdestarisë nëntor 2022, e datës 31.10.2022 QS-KSK Nr.373; Tabela nga pasqyra e orarit të kujdestarisë dhjetor 2022, e datës 01.12.2022 QS-KSK Nr.428; Aktgjykim REV.Nr.443/2021 e datës 10.01.2022 nga Gjykata Supreme e Kosovës; Aktvendim për Papranueshmëri në Rastin nr.KI 37/22 i datës 26.09.2022 Nr. Ref.RK2047/2022 nga Gjykata Kushtetuese Vlerësimi i Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme REV.nr.443/21 të 10.01.2022; Përgjigje në ankesë e datës 07.12.2022 nr. Protokolli 7753/2022; Akt Emërimit e datës 19.01.2012 me numër protokolli 12 të ankuesit Akt emërimit e datës 01.08.2013 me numër protokolli 210 të ankuesit Akt emërimit e datës 30.04.2014 me numër protokolli 103, të ankuesit Akt emërimit i datës 19.01.2012 me numër protokolli 13, të ankuesit Akt emërimit i datës 01.08.2017 me numër protokolli 183, të ankuesit Raporti 1. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 2. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 3. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 4. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 5. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 6. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Raporti 7. i prezencës në punë për periudhën nga data 01.10.2022 deri me datës 30.11.2022; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 13.01.2014 prej 1/6 faqe; E-mail i datës 14.10.2022 nga znj për ankuesit-rregullorja e re orari i punës /pushimet e zyrtareve publik prej 1/3 faqe; E-mail i datës 10.11.2022 nga ankuesi për -kërkesë për kompensim tetor 2022;E-mail i datë 25.11.2022 nga Refuzim i kërkesë në attch. Sipas e-mailit të datës 10.11.2022 prej ½ faqe; Kërkesë e datës 09.09.2015 nr.203/15 për miratimin e orarit të punës për Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës ½ faqe; Aprovim nr.5353 i datës 02.12.2015 i orarit të punës me ndërrime në Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nga Udhëheqësi i divizionit DASHC/MAP; Tabela e pasqyrës së kujdestarive nëntor 2022 nr. Protokolli 416 i datës 23.11.2022; Tabela e pasqyrës së kujdestarive nëntor 2022 nr. Protokolli 375 i datës 02.11.2022; Tabela e pasqyrës së kujdestarive nëntor 2022 nr. Protokolli 373 i datës 31.10.2022; Tabela e pasqyrës së kujdestarive tetor 2022 nr. Protokolli 333 i datës 05.10.2022; Tabela e pasqyrës së kujdestarive tetor 2022 nr. Protokolli 331 i datës 04.10.2022; Tabela e pasqyrës së kujdestarive tetor 2022 nr. Protokolli 326 i datës 30.09.2022; Plotësimin e ankesës me datës 19.12.2022 me numër të protokollit 8208/2022, të parashtruar nga ankuesi për mes adresës: ankesa.kpmshck@rks-gov.net prej 1/3 faqe; Libri i kujdestarive të Qendrës së Situatave, si në vijim: Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 01.10.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 02.10.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 03.10.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 04.10.2022 nga ora 19:50-08:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 06.10.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 01.10.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës 08.10.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës

26.11.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi .	dhe	; Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
27.11.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
28.11.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
29.11.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi	dhe	Plotësimin e ankesës me datës
30.12.2022 me numër të protokollit 8612/2022; E- mail i datës 28.12.2022 nga ankuesi për		
-Njoftim ; Email i datës 28.12.2022 nga	për ankuesit-Njoftim prej ¼ faqe; E-mail i datës	
27.12.2022 nga	për dhe Njoftim;	Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
01.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
02.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
03.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
04.12.2022 nga ora 08:00 -19:50 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
05.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
06.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
07.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
08.12.2022 nga ora 07:50 -20:20 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
09.12.2022 nga ora 19:40-08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
10.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
11.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
12.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
13.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
14.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
15.12.2022 nga ora 08:00 -19:45 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
16.12.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
17.12.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
18.12.2022 nga ora 20:00-08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
19.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
20.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
21.12.2022 nga ora 08:00 -19:45 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
22.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
23.12.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
24.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
25.12.2022 nga ora 20:00-08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
26.12.2022 nga ora 20:00 -08:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
27.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
28.12.2022 nga ora 08:00 -20:00 ankuesi		; Shkresat zyrtare të kujdestarisë, të datës
29.12.2022 nga ora 08:00-20:00 ankuesi		Tabela nga pasqyra e kujdestarisë dhjetor 2022
me Nr.450 e datës 16.12.2022.		

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e bazuar, sepse:

Ankuesit në ankesën e datë 03.04.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrë spër Shëfibmin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjesë për rishqyrimin e kërkesës me Nr. Prot:126 të datës 28.03.2023 të Drejtorit të Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, pretendojnë që kjo përgjigje është në kundërshtim me Vendimin A.nr.1088/2023 të datë 16.01.2023 të Këhsillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin Nr.

05/-031 për Provedurën e Përgjithshme Administrative dhe akteve të tjera në të aplikushme në kohë që ndëlidhen me kompensimin e shtesës mbi pagën bazë, duke kërkuar nga Këshilli që ankesa të aprovohet dhe të obligohet Këshilli i Sigurisë së Koosvës që të bëjë komoensimin e shtesës mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve për njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë për punën *e kujdestarisë, punën jashtë orarit, punë e natës, punën gjatë vikendit dhe punën gjatë festave zyrtare për muajin tetor dhe nëntor 2022*, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"Paga e nëpunësve civilë përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë, të përcaktuara me këtë ligj"*, ndërsa referuar nenit 14 të këtij ligji, janë përcaktuar edhe llojet e shtesave që mund të aplikohen ndaj nëpunësve civil, ku përcaktohet se: *"Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, ndërsa në mënyrë të hollësishme më akt nënligjor janë përcaktuar edhe mënyrat e realizimit të shtesave që derivojnë nga ky ligj, si rrjedhojë Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 4 ka paraparë llojet e shtesave, ndërsa neni 5 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar llojet e kompensimeve ndaj nëpunësve civil, po ashtu neni 10 dhe 11 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kushtet dhe planifikimin e buxhetit për pagesën e shtesave dhe kompensimeve respektivisht kompensimi për punë jashtë orarit. Po ashtu lidhur me këtë çështje Kolegji i Këshillit ju referua Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë e cila në nenin 8 ka përcaktuar punën jashtë orarit dhe mënyrat e kompensimit të tyre, ndërsa neni 56 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se çështja e shtesës apo kompensimeve mbi pagën bazë është e rregulluar edhe me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik konkretisht me nenin 35, ku janë përcaktuar edhe kompensime si: 1. *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit"*, ndërsa neni 36 paragrafi 2 i këtij ligji ka rregulluar përqindjen e kompensimeve të tilla ku përcaktohet se: *"2. Kompensimi sipas paragrafit 1. të këtij neni paguhet në përqindje të pagës bazë sipas ligjit përkatës për punë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës"*, rrjedhimisht edhe Rregullorja (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës ka përcaktuar mënyrat e kompensimeve të cekura si më lartë, duke përcaktuar edhe hapat procedural për miratimin e këtyre kompensimeve konkretisht neni 7 paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje kanë përcaktuar se: *"1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuari*



ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi në i lartë i institucionit”, po ashtu janë përcaktuar edhe shumat në bazë të të cilave mund të bëhet ky kompensim.

Referuar dispozitave të cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, se ankuesit kanë të drejtë të kompensohen për punë e kryer gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punë e natës, punën gjatë vikendit dhe punën gjatë festave zyrtare, nga fakti se te njëjtit para organit të punësimit kanë sjellë dëshmi se kanë kujdestaruar dhe kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës duke përfshirë edhe ditët e vikendit dhe ditët e festave zyrtare nga muaji tetor deri në momentin e parashtrimit të ankesës, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit pretendimet e ankuesve janë të bazuara, ndërsa akti/përgjigja me Nr. port: 126 e datës 28.03.2023 lidhur me rishqyrtimin e kërkesës së ankuesve për kompensim e nxjerr nga Drejtorit të Qendrës së Situatave pranë Këshillit të Sigurisë së Kosovës, është i paqartë dhe kundërthënës dhe mbi këtë pikëpamje juridike Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti nuk ka dhënë arsytetime të sakta dhe konkrete lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesve dhe nuk ka mbështetje ligjore, andaj në kuptim të dispozitave ligjore ky akt është i paligjshëm sipas nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase për këtë çështje Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin KI37/22 të datës 26.09.2022 e ka shpall si të pa pranueshme kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 443/21 të datës 10 janar 2022, ku ndër të tjera është përcaktuar se të punësuarve u takon kompensimin për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare, në kuptim të kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se organi i punësimit/Këshilli i Sigurisë së Kosovës konkretisht Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës është i obliguar që në pajtim me këtë vendim dhe dispozitivin e tij të ndërmarr veprimet për kompensimet ndaj ankuesve.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.600/2023

Avdyl BEKTESHI



Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqesuesit të ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK- së;